



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E MBIKËQYRJES NË FUSHËN E DREJTËSISË PENALE DHE
SIGURISË PUBLIKE

Nr. 1007/2 prot.

Tiranë, më 20.04.2026

Lënda: Dhënie mendimi mbi projektudhëzimin e përbashkët të Komisionerit për të
Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Ministrit të
Punëve të Brendshme

MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME

Tiranë

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka administruar shkresën tuaj me nr. 1144/1 prot., datë 07.04.2026, protokolluar me tonën me nr. 1007 prot., datë 09.04.2026, me anë të të cilës dërgoni për mendim projektudhëzimin e përbashkët të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Ministrit të Punëve të Brendshme, të hartuar në zbatim të pikës 9, të nenit 5 të ligjit nr. 38/2025 “*Për përpunimin e informacionit të udhëtimit në Republikën e Shqipërisë*”, si dhe relacionin shoqërues të tij.

Nga shqyrtimi i materialeve të vendosura në dispozicion, konstatojmë se, baza ligjore mbi të cilën është hartuar projektudhëzimi i përbashkët nuk është e saktë, duke referuar në pikën 5, të nenit 5 të ligjit nr. 38/2025 “*Për përpunimin e informacionit të udhëtimit në Republikën e Shqipërisë*”. Në këtë kuadër, sugjerojmë saktësimin e referencës ligjore në përputhje me dispozitat përkatëse ligjore, konkretisht në pikën 9, të nenit 5 të ligjit 38/2025, me qëllim garantimin e qartësisë dhe saktësisë, gjatë zbatimit të aktit nënligjor.

Për sa më sipër, me reflektimin e propozimit të sipërpërmendur, Zyra e Komisionerit shprehet dakord me përmbajtjen e projektudhëzimit të përbashkët, duke vlerësuar përputhshmërinë e tij me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi